REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Primljeno/Prodato Recieved/Delivery	31. 10	201 8	vitit god year
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPHHCU	6461/2018		1/4

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne SlužbeKosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.589/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Gjylinaze Gola dhe Lulzim Aliaj - anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.589/2018 të datës 17.09.2018 të parashtruar nga ankuesi Elmi Morina me adresë fshati "Turjakë" në Komunën e Malishevës, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokati z. Bekim Kryeziu, nga Komuna e Malishevës, kundër Vendimit me numër 01-/286 të datës 07.09.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Malishevës , në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 1, dhe nenin 18 paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.10.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A. Nr. 589/2018, e datës 17.09.2018, e parashtruar nga ankuesi Elmi Morina.

II.Shfuqizohet Vendimi 01-1286, i datës 07.09.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Malishevës dhe **Anulohet** konkursi i datës 05.06.2018, i shpallur nga Komuna e Malishevës për pozitën „ Drejtor i SHFMU„ Fehmi Agani'', në Turjakë si dhe rekomandimi i datës 25.07.2018,për përzgjedhjen e kandidatëve të suksesshëm.

III. Obligohet Kryetari i Komunës se Malishevës dhe Menaxheri i Personelit në Komunën e Malishevës, për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Malishevës, gjegjësisht Drejtoria per arsim dhe Edukim me datë 05.06.2018, ka shpallur konkurs me numër reference 11/420 për plotësimin e vendit te lire te punës „Drejtor i SHFMU„ Fehmi Agani'', në Turjakë .

Ankuesi, Elmi Morina, ka aplikuar ne konkursin e shpallur të datës 05.06.2018 sipas formularit për pozitën „Drejtor i SHFMU„ Fehmi Agani", në Turjakë, në Komunën e Malishevës, i cili ka marrë pjesë në fazën e procedurës nga lista e ngushtë deri ne interviste me goje, si fazë e rekrutimit.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 25.07.2018, për përzgjedhjen përfundimtare te kandidatit te suksesshëm për pozitën „Drejtor i SHFMU„ Fehmi Agani", në Turjakë, me datë 31.07.2018, përmes Avokatit Bekim Kryeziu, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 11/703 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Malishevës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Malishevës, me datë 07.09.2018, ka nxjerr vendim me numër protokolli 01-1286, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit Elmi Morina.

Ankuesi, Elmi Morina, i pakënaqur me vendimin me nr. protokolli 01-1286, datës 07.09.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Malishevës, përmes Avokatit Bekim Kryeziu, me datën 10.09.2018, ka parashtruar ankesë përmes Postës së Kosovës, e cila ankesë është pranuar me datën 17.09.2018, me numër protokolli 5348/2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se procedurat e rekrutimit për pozitën "Drejtor i SHFMU„ Fehmi Agani", në Turjakë Komuna e Malishevës, është bërë në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore në fuqi, nga Komuna e Malishevës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 01.10.2018, me numër protokolli 5610/2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Komuna e Malishevës ndërsa me datën 12.10.2018 me numër protokolli 5963/2018, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Malishevës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5348/2018 e datës 17.09.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim i datës 30.07.2018; Vendim i datës 07.09.2018, me numër Nr.01-/286, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankese e ankuesit e datës 31.07.2018, me numër 11/703, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Konkursi i datës 05.06.2018, me numër Nr.11/420; Njoftim për kandidatet e suksesshëm për drejtor te shkollave i datës i datës 25.07.2018, me numër Nr.11/515; Formulari i aplikimit për punësim i ankuesit me shkresat e bashkangjitura; Përgjigja në ankesë e datës 04.10.2018; Kërkesa për punësim e kandidatit Agron Zogaj e datës 18.06.2018, me shkresat e bashkangjitura; Njoftim për Këshillin e shkollës për mbajtjen e intervistës për drejtor shkolle i datës 12.06.2018; Njoftim për mbajtjen e intervistës për drejtor shkolle i datës 08.06.2018; Qarkore e datës 20.07.2018; Aktvendim i datës 22.06.2018; Formulari H; Formulari E; Lista e aplikacione te pranuara me kandidatet konkurrues; Udhëzim administrativ i MASHT nr.08/2014; Formulari i aplikimit për punësim i kandidatit Aziz Avdiu i datës 18.06.2018, me shkresat e bashkangjitura; Formulari i aplikimit për punësim i kandidatit Sokol Paqarizi i datës 18.06.2018, me shkresat e bashkangjitura;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit Elmi Morina, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të qëndrueshme, lidhur me pretendimet se procedura e rekrutimit e zhvilluar për vendin e punës „Drejtor i SHFMU„ Fehmi Agani'', në Turjakë është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës ë Kosovës, Rregulloren 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 08/ 2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues.

Kolegji për vëzhgim, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se Komuna e Malishevës, me datë 05.06.2018 ka shpallur konkursin me numër reference 11/42, për pozitën „ Drejtor i SHFMU„ Fehmi Agani'', në Turjakë, mirëpo Komuna e Malishevës, ketë procedure te rekrutimi deri ne përzgjedhjen e kandidatit te suksesshëm e ka zhvilluar pa e njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për te vëzhguar ketë pozite, pasi që është pozite e nivelit drejtues, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 3 paragrafin 1 dhe 3 të Rregullores Nr. 01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Vëzhgimit për Emërimin e Nëpunësve Civilë të Nivelit Drejtues i cili përcakton se: „1.*"Çdo institucion i administratës publike i cili fillon procedurën e rekrutimit për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues është i obliguar që brenda pesë (5) ditësh nga momenti i publikimit të shpalljes së konkursit, të njoftojë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për fillimin e procedurës së rekrutimit"* **3.** *"Nëse zhvillimi i procedurës për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues, bëhet pa njoftim të Këshillit për pjesëmarrje në vëzhgim, Këshilli e anulon procedurën si të pavlefshme".* Duke marre parasysh se e gjithë procedura e rekrutimit është zhvilluar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli ka zbatuar dispozitat e Ligjit të vjetër Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ketë çështje .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Komuna e Malishevës me datë 05.06.2018 ka shpallur konkursin me numër reference 11/420 pa e marr autorizimin nga MAP/DASHC për plotësimin e vendit të lira të punës „Drejtor i SHFMU„ Fehmi Agani'', në Turjak, me ç'rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 15 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, që është përcaktuar se: *"Procedurat e rekrutimit, të cilat zhvillohen pa publikimin e shpalljes së rekrutimit, ose të cilat janë zhvilluar në rastet kur shpallja nuk është aprovuar nga MAP-i janë të pavlefshme".*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datën 21.09.2018 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Malishevës, ku në mes tjerash ka kërkuar edhe autorizimin për shpalljen e konkursit nga DASHC/MAP, mirëpo Komuna e Malishevës në përgjigjën në ankesë të datës 04.10.2018 nuk ka sjell asnjë provë që vërteton se Komuna ka pas autorizimin për shpalljen e konkursit të datës 05.06.2018 me numër 11/420 për pozitat për Drejtor të SHFMU dhe Drejtorëve të SHML. Andaj për tu siguruar lidhur me këtë çështje, Kolegji për shqyrtimin e

ankesave me date 08.10.2018, ka kërkuar informate zyrtare nga DASHC/MAP, lidhur me sqarimin dhe vërtetimin se a ka pasur kërkesë për shpallje nga ana e komunës se Malishevës dhe nëse ka pas kërkesë a eshët miratuar autorizimi për shpalljen e konkursit për këto pozita. DASHC/MAP me datë 19.10.2018, përmes e-mailit ka njoftuar Këshillin se: *„ nuk ka marre aprovim për konkursin ne fjale, dhe po ashtu Komuna e Malishevës edhe për drejtor të shkollave tjera nuk ka marrë aprovim ne DASHC."*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka konstatuar këto shkelje nuk është lëshuar ne trajtimin e mëtejme të lëndës dhe ka marre si rrethane vendimtare këto dy shkelje për aprovimin e ankesës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Malishevës, me nxjerrjen e Vendimit numër 01-1286 i datës 07.09.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Në rast të mos zbatimit të Vendimit të Këshilli, nga personi përgjegjës i përcaktuar ne dispozitiv te këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet ne pajtim me nenin 21,23, dhe 24 të Ligjit Nr. 06/l -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe **„ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit".**

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A. nr. 589/2018

Malsore GASHI-BAJRAKTARI	*Ardita Perçuku-Shyti*
Kryetare e Kolegjit	*Procesmbajtëse*

Vendimi i dërgohet:

- *Përfaqësuesit të ankuesit Avokatit Bekim Kryeziu;*
- *Kryetarit të Komunës së Malishevës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*